



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1742 prot.

Tiranë, më 22. 12. 2021

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave pozitive për përjashtimin nga tarifat e regjistrimit në kopshte, për fëmijët e familjeve në nevojë dhe fëmijëve që vijnë nga familje që i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian në Shqipëri.

BASHKISË KORÇË

Lagjja nr. 12, Bulevardi “Shën Gjergji”, Kodi Postar 7001,
KORÇË

BASHKISË TEPELENË

Rruga “Ali Pashë Tepelena”, Sheshi “Lord Bajron”,
TEPELENË

BASHKISË SARANDË

Rruga ”Abedin Dino”,
SARANDË

BASHKISË MALIQ

Bulevardi “Rinia”,
MALIQ

BASHKISË DIVJAKË

Pranë Sheshit “Santa Barbara”,
DIVJAKË

BASHKISË GRAMSH

Sheshi "Kamber Dermushi", Lagjja "Holta", Rruga"10 Korriku", Kati I,
GRAMSH

BASHKISË PEQIN

Bulevardi “Mustafa Gjinishi”,
PEQIN

BASHKISË BELSH

Rruga “Haziz Dervishi”,
BELSH

BASHKISË URË VAJGURORE
Rruga “Dimal”, Lagjia “18 Tetori”,
URA VAJGURORE

BASHKISË POLIÇAN
Lagjia “Qendër” Poliçan, 5404,
POLIÇAN

BASHKISË ROSKOVEC
Lagja Nr. 1, Qendër,
ROSKOVEC

BASHKISË KONISPOL
KONISPOL

BASHKISË MIRDITË
Rruga “Atë Gjergj Fishta”,
RRËSHEN

BASHKISË HIMARË
Spile,
HIMARË

BASHKISË FUSHË-ARRËZ
Rruga Qendër,
FUSHË ARRËZ

BASHKISË LIBOHOVË
Rruga “Avni Rustemi”,
LIBOHOVË

BASHKISË KOLONJË
Sheshi “Rilindja”,
KOLONJË

BASHKISË PUKË
Sheshi “Tërbuni”,
PUKË

BASHKISË DELVINË

Lagjja “Sinan Ballaci,” Rruga “Nazif Hadëri”,
DELVINË

BASHKISË SKRAPAR

Lagjja “Çlirimi”, Rruga “Pasho Hysi”, Çorovodë,
SKRAPAR

BASHKISË HAS

Sheshi “Deshmorët e Hasit”, Pallati Kulturës, “Pjetër Bogdani”, Qyteti Krumë,
HAS

BASHKISË PUSTEC

Pustec,
KORÇË

BASHKISË KËLCYRË

Sheshi “Musa Fratari”,
KËLCYRË

BASHKISË CËRRIK

Lagja Nr. 2, Rruga “Bulevardi Gjinnazi 1962”,
CËRRIK

BASHKISË KURBIN

Lagja Nr. 3,
LAÇ

BASHKISË RROGOZHINË

Lagjja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori”,
RROGOZHINË

BASHKISË LIBRAZHD

Sheshi “Gjorg Golemi”,
LIBRAZHD

BASHKISË FINIQ

Finiq,
DELVINË

BASHKISË LUSHNJË
Lagjja "Kongresi i Lushnjes", 9001
LUSHNJË

BASHKISË MEMALIAJ
Rruga "Tafil Buzi", Godina Nr.7,
MEMALIAJ

BASHKISË FIER
Lagjja "Kryengritja e Fierit", Rruga "Ramiz Aranitasi",
FIER

BASHKISË ELBASAN
Rruga "Qemal Stafa",
ELBASAN

BASHKISË GJIROKASTËR
Sheshi "Çerçiz Topulli",
GJIROKASTËR

BASHKISË PATOS
Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza",
PATOS

BASHKISË PRRENJAS
Rruga "Skënderbej",
PRRENJAS

BASHKISË SHIJAK
Lagjja "Erzen",
SHIJAK

BASHKISË BULQIZË
Lagjja "Minatori",
BULQIZË

BASHKISË KUÇOVË
Blloku Nr.1, Lagja "Tafil Skendo",
KUÇOVË

BASHKISË DIBËR

Bulevardi Elez Isufi,
PESHKOPI

BASHKISË VLORE

Sheshi “4 Heronjtë”,
VLORE

BASHKISË KRUJË

Sheshi “Skënderbej”,
QENDËR KRUJË

BASHKISË KAVAJË

Bulevardi “Josif Buda”,
KAVAJË

BASHKISË DURRËS

Sheshi “Liria”, 2000,
DURRËS

BASHKISË BERAT

Rruga “Antipatrea”,
BERAT

BASHKISË MALËSI E MADHE

Koplik Qendër,
MALËSIA E MADHE

BASHKISË VAU I DEJËS

Rruga “Qafa e Gurit”,
VAU DEJËS

BASHKISË POGRADEC

Bulevardi "Rreshit Collaku",
POGRADEC

BASHKISË VORË

Rruga “Unaza”, Nr. 73,
VORË

BASHKISË MAT

Sheshi “Ahmet Zogu”,
BURREL

BASHKISË SELENICË

SELENICË

BASHKISË KLOS

Klos,
MAT

BASHKISË PËRMET

Shëtitorja “Abdyl Frashëri”,
PËRMET

BASHKISË TROPOJË

Sheshi “Azem Hajdari”, Bajram Curri,
TROPOJË

BASHKISË MALLAKASTËR

Lagjja “18 Prilli”,
BALLSH

BASHKISË KUKËS

Sheshi “Skënderbej”, Lagjja 5,
KUKËS

BASHKISË DEVOLL

Lagjja Nr.1, Rr. “24 Tetori”, Nr. 9,
DEVOLL

BASHKISË LEZHË

Lagjja “Skënderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti”,
LEZHË

BASHKISË KAMËZ

Bulevardi "BLU", Nr. 492,
KAMËZ

BASHKISË SHKODËR
Rruga “13 Dhjetori”, Nr. 1,
SHKODËR

BASHKISË DROPULL
Jergucat,
GJIROKASTËR

Për dijeni: **KËSHILLIT TË MINISTRAVE**
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
TIRANË

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar², si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi, si dhe çdo formë sjelljeje që e nxit atë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), përcaktohet se: “Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “c”, të LMD, ku përcaktohet se: “Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”, si dhe bazuar në informacionin e administruar gjatë shqyrtimit të 5 (pesë) ankesave të ardhura nga familje që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian të qytetit të Tiranës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Urdhrin Nr. 68, datë 11.04.2019, nisi procedurën për trajtimin e çështjes së regjistrimit të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në kopshte.

I. Parashtrimi i fakteve sipas ankesave të ardhura nga familje që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian të qytetit të Tiranës.

Sipas informacionit të administruar gjatë shqyrtimit të 5 (pesë) ankesave të ardhura nga familje që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian të qytetit të Tiranës, në muajin Qershor 2018, kanë kërkuar të regjistrojnë fëmijët në çerdhe dhe kopësht, por nuk kanë mundur për shkak të tarifës së përcaktuar nga ana e Bashkisë Tiranë. Ky detyrim mujor, sipas tyre, ka qënë i papërballueshëm për shkak të kushteve ekonomike në të cilat ndodhen këto familje. Sipas pretendimeve të tyre, në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 40, datë 29.03.2018 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, janë përcaktuar disa kategori të familjeve, ku fëmijët e tyre përfitojnë pa pagesë shërbimin në kopësht.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

Ndonëse janë përcaktuar disa kategori që përfitojnë falas, disa të tjera janë lënë jashtë kësaj liste dhe nuk mund të klasifikohen në asnjrën prej tyre. Disa prej këtyre rasteve ishin edhe familjet e ankuesve, të cilët nuk trajtoheshin me ndihmë ekonomike dhe në këto kushte nuk arrijnë të përfitojnë regjistrimin falas të fëmijëve në kopësht, pasi nuk bëjnë pjesë në asnjë prej kategorive përfituese.

Në përfundim të trajtimit të ankesave të sipërcituara, Komisioneri vlerësoi se Bashkia Tiranë ka diskriminuar fëmijët e subjekteve ankues duke dështuar të krijojë përjashtim nga rregulli për fëmijët rom dhe egjiptian edhe pse është në dijeni të situatës aktuale të këtyre komuniteteve si dhe është angazhuar për integrimin e këtyre komuniteteve bazuar në politikat e hartuara nga shteti shqiptar për krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta në shoqërinë shqiptare.

Gjithashtu, Komisioneri konstatoi se praktika e ndjekur nga Bashkia Tiranë dhe Këshilli Bashkiak Tiranë, duke mos përfshirë si kategori të veçantë regjistrimin në kopësht të fëmijëve të komunitetin rom dhe egjiptian, si dhe miratimi i VKB³-së Nr. 40, datë 29.03.2018, duke pretenduar se këto familje duhet të përfitojnë nga pika 6 e vendimit, i ka trajtuar të gjitha familjet njëloj pa marrë parasysh kushtet e ndryshme sociale që mund të kishin, përbën diskriminim substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) për shkak të etnisë⁴, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, pasi kemi të bëjmë me trajtimin e çështjes së arsimit të fëmijëve të familjeve të komunitetit rom dhe respektimit të të drejtave të tyre, si një element i theksuar qartë edhe në pesë prioritetet, që vendi ynë duhet të përmbushë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesave të sipërcituara, Komisioneri konstatoi diskriminimin e ankuesve nga ana e Bashkisë Tiranë, duke kërkuar në vijim, marrjen e masave të menjëhershme për hartimin dhe përfshirjen e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe egjiptian, si kategori që përfiton regjistrimin në kopshte pa pagesë.

Në përgjigje të vendimmarrjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga ana e Këshillit Bashkiak Tiranë, në Vendimin Nr. 158, datë 26.12.2019 *“Për Miratimin e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës”*, janë përcaktuar llojet e taksave dhe tarifave

³ Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë përcakton disa kategori që përfitojnë pa pagesë shërbimin në çerdhe dhe kopësht për fëmijët e tyre, ku ndër to janë:

1. Fëmijët me statusin e jetimit;
2. Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit;
3. Fëmijë me aftësi të kufizuara;
4. Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuara;
5. Fëmijë të familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës;
6. Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

⁴ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, që justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

vendore që zbatohen në territorin e Bashkisë Tiranë, nivelin e taksave dhe tarifave etj. Në pikën 8 të nenin 66, të këtij vendimi, në vijim të tarifave për kopshtet dhe çerdhet, Këshilli Bashkiak Tiranë ka parashikuar: *“Përfitojnë shërbim pa pagese familjet në nevojë me përbërje:...8. Fëmijë të familjeve të pakicës rome dhe egjiptiane, sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga organizatat që mbrojnë të drejtat e tyre ose vetë deklarimit ku përcaktohet se familja është pjesë e këtyre pakicave”*.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën Nr. 664 prot, datë 02.05.2019, është kërkuar informacion, lidhur me praktikën e ndjekur për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në kopshte. Kërkesa për informacion i është dërguar 60 bashkive të Republikës së Shqipërisë.
2. Për shkak të organizimit të zgjedhjeve vendore në muajin Qershor 2019 dhe pas emërimit të kryetarëve të rinj të bashkive respektive, me shkresën nr. 1317 prot., datë 04.09.2019, i është dërguar sërish 25 subjekteve që nuk kishin dërguar informacionin e kërkuar. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, 15 prej subjekteve dërguan informacion.
3. Për shkak të mungesës së përgjigjes nga 10 prej bashkive, me Vendimin Nr. 163, datë 11.11.2019, ndaj këtyre subjekteve u vendos saksion me gjobë për shkak të mos vënies në dispozicion të informacionit të kërkuar nga KMD. Pas sanksionit me gjobë, subjektet përcollën informacionin e kërkuar. Në këto kushte dhe referuar Nenit 33/11 të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, në të cilin citohet: *“...Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”*, me Vendimin Nr. 197, datë 26. 12. 2019, Komisioneri shfuqizoi sanksionin me gjobë pasi subjektet zbatuan vendimin e KMD-së, duke kthyer përgjigjen e kërkuar.
4. Në përfundim, 60 bashkitë vunë në dispozicion një pjesë të informacionit të kërkuar lidhur me:
 - procedurën e miratuar për me regjistrimin e fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor në kopshte.
 - kopje të aktit ku është parashikuar procedura e regjistrimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor në kopshte.
 - informacion nëse janë hartuar nga ana e njësive të qeverisjes vendore, politika specifike dhe masa konkrete për regjistrimin e fëmijëve që vijnë nga familje në nevojë apo familje që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Nëse po, kopje të tyre.
 - numrin e fëmijëve të regjistruar në sistemin arsimor parashkollor në kopshte që vijnë nga familje në nevojë apo familje që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian.

5. Përsa më sipër, është evidentuar se një numër shumë i vogël i njësive vendore kanë vënë në dispozicion informacionin e plotë të kërkuar nga ana e Komisionerit. Megjithatë, nga informacioni i administruar rezultoi se:

- Nga 60 bashkitë ndaj të cilave u është kërkuar informacioni, nëse ka fëmijë që i përkasin komunitetit rom apo atij egjiptian, të regjistruar në kopshte, 11 prej tyre kanë sqaruar se nuk kanë asnjë fëmijë të këtyre komuniteteve të regjistruar;
- 2 prej 60 bashkive nuk kanë dhënë informacion nëse kanë fëmijë të regjistruar që i përkasin këtyre komuniteteve;
- Nga 60 bashki, vetëm 9 prej tyre kanë hartuar politika specifike (Vendime të Këshillit Bashkiak) dhe kanë marrë masa konkrete për regjistrimin e fëmijëve pa pagesë që vijnë nga familje në nevojë apo familje që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian;
- Nga 60 bashki, vetëm 2 prej tyre kanë informuar se ofrojnë regjistrimin në kopshte dhe ushqimin gjatë drekës, pa pagesë për të gjithë fëmijët;
- Nga 60 bashki, vetëm 9 prej tyre kanë informuar se ofrojnë regjistrimin në kopshte pa pagesë për të gjithë fëmijët;
- Nga 60 bashki, vetëm 3 prej tyre kanë informuar se ofrojnë regjistrimin me pagesë;
- Numri i përafërt i fëmijëve që i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian, të regjistruar në sistemin parashkollor (kopshte dhe çerdhe), nga informacioni i dhënë nga një pjesë e bashkive, është rreth 1100 fëmijë, por nuk mund të themi se ky numër është i saktë, pasi një pjesë e Bashkive, nuk kanë dhënë informacion të detajuar rreth fëmijëve të këtyre dy komuniteteve.

III. Legjislacioni i zbatueshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 57

1. Kushdo ka të drejtën për arsimim.
2. Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.
3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë.
4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.
5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.

6. Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.

Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut⁵ (KEDNJ)

Neni 14

“Ndalimi i diskriminimit”

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindaj ose çdo status tjetër.

Protokolli 12, KEDNJ

Neni 1

“Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindaj ose çdo status tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës⁶

Neni 2

1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t’ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht

⁵ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

⁶ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr 7531, datë 11.12.1991.

nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionimi politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Neni 3

1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

2. Shtetet Palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

Neni 4

Shtetet Palë angazhohen të marrin të gjitha masat legjislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë dhe, kur është nevoja, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 28

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:

a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;

e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.

Neni 29

1. Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë të ketë për synim:

- (a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;
- (b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

“Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial”, e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr. 7768, datë 09 Nëntor 1993, synon që shtetet palë dënojnë diskriminimin racial dhe zotohen të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë, një politikë të zhdukjes së çdo forme të diskriminimit racial, të ndihmojnë mirëkuptimin midis të gjitha racave, dhe të realizojnë angazhimet e marra përsipër sipas Konventës.

Në nenin 5 të saj, ndër të tjera Konventa parashikon se, shtetet palë zotohen të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e të drejtës për arsim.

Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

Neni 1

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.
2. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.

Neni 5

1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

Neni 6

1. Në veprimtaritë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, interesi i nxënësit është parësor.
2. Në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat e liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti.
3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral.
4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.
5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.
7. Veprimtaria e institucioneve në sistemin arsimor parauniversitar dhe e punonjësve të tyre është transparente dhe e bazuar në llogaridhënie ndaj përfituesve të shërbimit arsimor.
8. Në sistemin arsimor parauniversitar garantohet e drejta e nxënësve, e punonjësve arsimorë, e prindërve dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë, më poshtë “prindër”, për të shprehur pikëpamjet e tyre për cilësinë e shërbimit arsimor dhe për t’u dëgjuar për këto pikëpamje.
9. Sistemi arsimor parauniversitar funksionon mbi bazën e decentralizimit dhe autonomisë së institucioneve arsimore.
10. Në sistemin arsimor parauniversitar garantohet e drejta e organizimit të nxënësve, mësuesve dhe prindërve për të mbrojtur të drejtat e tyre, si dhe për të dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e institucionit.
11. Shërbimi arsimor mbështetet dhe vlerësohet mbi bazën e standardeve. Vlerësimi është i brendshëm dhe i jashtëm.

Neni 28

1. Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë:
 - a) ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transfertat e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;
 - b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;
 - c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;
 - ç) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.
3. Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.
4. Njësia bazë e qeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e njësive arsimore vendore dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive vendore, mbështet:
 - a) nxënësit e familjeve në nevojë;
 - b) nxënësit me arritje të shkëlqyera;
 - c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës;
 - ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.

Neni 30

Ministria përfaqësohet në nivelin vendor nga njësitë arsimore vendore, të cilat krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Struktura dhe organika e tyre miratohen me urdhër të Kryeministrit.

2. Njësitë arsimore vendore janë drejtoritë arsimore, në nivel qarku, dhe zyrat arsimore, në nivel rrethi.

3. Njësia arsimore vendore është përgjegjëse për funksionimin e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të saj.

4. Njësia arsimore vendore:

a) zbaton Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;

b) mbështetet institucionet arsimore për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor;

c) bashkëpunon me njësinë bazë të qeverisjes vendore për planifikimin, realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore, si dhe për rastet e braktisjes së shkollës;

ç) siguron për institucionet arsimore publike mjetet mësimore, sipas formulës “për nxënës”.

d) përdor fondin e veçantë të buxhetit vjetor për shpërblimin e punonjësve të institucioneve arsimore publike me arritje të shquara. Kriteret e përdorimit të këtij fondi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

Neni 1

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Neni 2

Ky ligj ka për qëllim:

a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;

b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;

ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;

d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;

dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;

e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Neni 6

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

Neni 18

1. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim që:

e) të krijojnë kushtet e nevojshme, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit, nëpërmjet kurrikulave, mjeteve mësimore, infrastrukturës së përshtatshme, si dhe të vlerësimit periodik të personelit mësimor;

ë) të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, materiale e financiare për të siguruar arsimimin cilësor të fëmijës;

f) të ndërmarrin veprime konkrete.

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

Neni 1

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse.

Neni 23

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:...

11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.

12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar

Neni 1

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3

1. “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Neni 17

1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

- a) krijimin e institucioneve publike ose private që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;
 - b) financimin e institucioneve publike që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;
 - c) përmbajtjen e parimeve dhe kriterëve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies;
 - ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.
2. Ndalohet t’i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.
3. Ndalohet çdo lloj shqetësimi, veçanërisht shqetësimi seksual, i studentëve, nxënësve dhe punëmarrësve në institucionet arsimore.

4. Zbatimi i masave të posaçme dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim përshpejtimin e barazisë në arsim, nuk konsiderohet diskriminim. Zbatimi i masave të tilla, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen e përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe këto masa ndërpriten kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

Neni 22

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 32

1. Komisioneri ka kompetencë:

...c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

...ë) t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;

IV. Arsyetimi ligjor

Në përfundim të analizës së legjislacionit sipërcituar, rezultoi se:

Qëllimi i përbashkët i këtyre akteve ligjore dhe nënligjore është që nëpërmjet tyre të garantohet e drejta e fëmijës për trajtim dinjitoz dhe në interesin e tij më të lartë, në fushën e arsimit.

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim pavarësisht nga vendbanimi i personit. E drejta për arsim garantohet edhe në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t'u zbatuar.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionin të drejtën e fëmijës për tu arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta.

Ligji nr. 69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënës duhet t'i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim, pavarësisht nga vendi ku ai banon apo ndjek shkollën: qoftë ajo në zonë urbane apo rurale.

Fëmijët gëzojnë të drejtën për një mbrojtje të posaçme. Ligji i posaçëm që mbron të drejtat e fëmijës, konkretisht ligji nr. 18/2017 *“Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”*, sanksionon se

realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke u bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim.

Legjislacioni në fuqi në përputhje me standartet ndërkombëtare parashikon që e drejta për arsim garantohet pa diskriminim për të gjithë fëmijët. Por garantimi i të drejtës për arsim nuk nënkupton vetëm pranimin në shkollë dhe prezencën fizike të fëmijëve në klasa, por që fëmijët të marrin një arsim cilësor dhe të barabartë për të gjithë.

Vazhdimisht në legjislacionin shqiptar janë parashikuar mekanizma për të stimuluar arsimimin dhe edukimin, nëpërmjet lehtësirave për fëmijët që vijnë nga komuniteti rom/egjiptian.

Në këtë kuadër, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072, datë 23.12.2015, vjen si një dokument i rëndësishëm i Qeverisë Shqiptare. Ai është tërësisht i mbështetur, jo vetëm në parimet bazë të Kushtetutës së Shqipërisë por edhe në parimet themelore të antidiskriminimit të të gjitha Konventave Ndërkombëtare. Ky Plan, përfshin politika specifike dhe masa konkrete, që institucionet përgjegjëse do të ndërmarrin në realizimin e objektivave, në sektorët respektivë dhe programet publike, që synojnë të përmirësojnë jetesën e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Arsimimi i komunitetit rom dhe egjiptian, ka qënë pjesë e pesë prioritetëve kyçe që rezultojnë nga dialogu politik i nivelit të lartë midis qeverisë dhe BE-së, duke përfshirë: *“masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese”*⁷. Përmbushja e Prioritetit 5 në Udhërrëfyesin e Qeverisë, orienton marrjen e masave në shumë fusha të politikave specifike për Romët/Egjiptianët si: regjistrimi civil, aksesit në drejtësi, arsimi, dialogu ndërkulturor, punësimi dhe përmirësimi i aftësive, kujdesi shëndetsor, strehimi dhe integrimi urban dhe mbrojtja sociale. Arsimimi i fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në arsimin parashkollor janë pjesë integrale e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020.

Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, njësitë e qeverisjes vendore duhet të krijojnë mundësinë për integrim e komuniteteve romë dhe egjiptiane, në krijimin e rrethanave dhe mundësive që fëmijët e këtyre komuniteteve të frekuentojnë ciklin parashkollor. Ata duhet t’u japin përparësi familjeve të varfra e familjeve që i përkasin komuniteteve të veçanta, për të cilat përfitimi i shërbimeve arsimore nuk është shumë i lehtë.

Gjithashtu, Plani i ri Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve⁸ (2021–2025), ka theksuar sërish se një ndër prioritetet kyçe të tij përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në sistemin arsimor. Qëllimet e politikës së këtij Plan Veprimi, konsiston në:

⁷ Bashkimi Evropian, Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2013-2014, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/strategy_paper_2013_en.pdf, f. 19.

⁸ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701, datë 18.11.2021.

1. Qasjen e barabartë në drejtësi dhe shërbime të gjendjes civile për romët dhe për egjiptianët.
2. Përmirësimin e kushteve të strehimit për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane, si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve joformale.
3. Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis romëve dhe egjiptianëve dhe pjesës tjetër të popullsisë.
4. Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore.
5. Krijim i mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për romët dhe egjiptianët.
6. Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianeve në programet e mbrojtjes sociale.
7. Antixhopsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve sistematike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliruar nga diskriminimi ndaj R&E.

Në kuadër të plotësimit të Objektivit specifik 1 “Arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore”, citohet se: *“Familje rome dhe egjiptiane me të ardhura mujore nën pagën minimale hasin vështirësi për të përballuar tarifat dhe kostot e tjera që lidhen me regjistrimin/frekuentimin e kopshtit dhe arsimit të detyrueshëm. Në këtë drejtim plani parashikon që njësitë e vetëqeverisjes vendore të sigurojnë dhe të përmirësojnë kushtet për arsim cilësor gjatë fëmijërisë së hershme, nëpërmjet regjistrimit të të gjithë fëmijëve romë dhe egjiptianë 3–6 vjeç në arsimin parashkollor, duke i përjashtuar nga tarifat financiare dhe pagesat për ushqim. Gjithashtu do të sigurohet transport falas për nxënësit romë dhe egjiptianë, të cilët banojnë larg kopshteve dhe shkollave (edhe nën distancën 2 km për raste specifike të justifikuara). Ndërkohë që plani parashikon edhe rritje të subvencionimit shtesë, mbi ndihmën ekonomike, për nxënësit romë dhe egjiptianë që ndjekin rregullisht arsimin e detyrueshëm...”*

Gjithashtu, masa të tjera të rëndësishme në këtë plan për këtë objektiv lidhen me mbështetjen e familjeve rome dhe egjiptiane, fëmijët e të cilëve frekuentojnë arsimin parashkollor dhe atë bazë. Në këtë drejtim, në plan parashikohet:

- i. priorizim i regjistrimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në çerdhe dhe në kopshte;
- ii. rritja e shumës së subvencionit të pagesës të ndihmës ekonomike që marrin familjet rome dhe egjiptiane, fëmijët e të cilëve ndjekin arsimin bazë dhe vaksinohen;
- iii. miratimi i VKB-ve për reduktim/përjashtimin nga detyrimi financiar për çerdhe dhe kopshte për fëmijët nga familjet rome dhe egjiptiane.

Edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore: Tiranë, Korçë dhe Lezhë kanë hartuar Planin Lokal për Zhvillimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, ndërsa bashkitë: Berat, Shkodër, Pogradec, Përmet, Urë Vajguore, Fier, Bulqizë, Vau i Dejës, Krujë, Skrapar, Pukë, Patos, Poliçan, Malësi e Madhe dhe Kolonjë kanë hartuar Planet e Kujdesit Social, si një instrument planifikimi dhe menaxhimi që synon të adresojë në terma afatshkurtër sfidat me të cilat përballen shtresa të ndryshme sociale

dhe komunitetet rome apo egjiptiane, duke synuar në arritjen e një vizioni që lidhet me një shkallë më të lartë integrimi të anëtarëve të të dy komuniteteve në jetën sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Planet e Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian apo Planet Sociale të bashkive, fokusohen në trajtimin e sfidave të identifikuar edhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, të lidhura ngushtë me kontekstin vendor. Këto plane zhvillimi janë hartuar me synimin që të shërbejnë si instrumenta për orientimin e përpjekjeve ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe në lidhje me integrimin social dhe ekonomik të dy komuniteteve në bashkitë respektive. Njohja e mirë e potencialeve dhe sfidave me të cilat përballen dy komunitetet në 6 fushat prioritare: regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë, arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe formimi profesional, strehimi dhe integrimi urban, si dhe mbrojtja sociale, arrin të mbulojë dhe adresojë gamën e gjerë të problematikave shumëdimensionale të dy komuniteteve.⁹

Nga një analizë të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 dhe Planeve Lokale të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkitë e vendit, evidentohet se një ndër konstatimet e bëra në këto dokumenta është niveli i arsimimit të popullsisë rome, dhe në një masë më të vogël egjiptiane, është shumë më i ulët se i banorëve të tjerë. Varfëria dhe kushtet e jetesës ndikojnë drejtpërdrejt në mundësitë e fëmijëve romë dhe egjiptianë për t'u arsimuar.¹⁰ Gjithashtu, në këto dokumenta të hartuara theksohet fakti që sipas të dhënave evidentohet se regjistrimi në arsimin parashkollor është dukshëm më i ulët për fëmijët që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian.¹¹

Në Planet Lokale të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian apo Planet Sociale të bashkive, pasqyrohen si qëllime strategjike dhe objektiva: *“Rritja e numrit të fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin të gjithë nivelet e arsimimit (parashkollor, arsimi bazë, të mesëm dhe të lartë)...”*.

Gjithashtu, edhe në Planet Lokale të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkitë e vendit një ndër qëllimet strategjike dhe objektivat sipas fushave prioritare janë edhe ofrimi falas i kopshteve dhe çerdheve për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë, kryesisht duke përfshirë edhe fëmijët që vijnë nga komunitetet e sipërcituara.

Pavarësisht faktit që bashkitë e vendit në Planet Lokale të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian, kanë evidentuar problematika dhe ndër prioritetet e tyre ka qenë ofrimi falas i kopshteve dhe çerdheve, nga informacioni i administruar rezultoi se, vetëm 9 prej tyre kanë hartuar politika specifike (Vendime të Këshillit Bashkiak) dhe kanë marrë masa konkrete për regjistrimin e fëmijëve që vijnë nga familje në nevojë apo familje që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Gjithashtu, vetëm 2 prej njësive vendore ofrojnë pa pagesë regjistrimin dhe ushqimin në çerdhe dhe kopshte, për të gjithë fëmijët. Pra, në këtë kuptim edhe pse janë

⁹ Marrë nga Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2017-2020, i Bashkisë Tiranë

¹⁰ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, fq. 28

¹¹ Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, fq. 18

evidentuar problematika që lidhen me arsimimin e këtyre fëmijëve, rezulton që nuk janë ndërmarrë masa për përmirësimin e kësaj situate nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vitin 2014, ka miratuar Udhëzimin Nr. 21, datë 08.08.2014 *“Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”*, ku në Kreun I, pika 2, ka vendosur që: *“Drejtuesit e kopshteve dhe drejtuesit e shkollave që kanë në varësi kopshte: a) Të regjistrojnë me përparësi fëmijët romë në kopshte, sidomos në zonat e banuara nga popullsia romë. Në rastet kur kopshti nuk ka kapacitet për të përmbushur nevojat e bashkësisë përreth tij, t’u jepet përparësi fëmijëve të komunitetit rom. b) Të bashkëpunojnë me njësitë bazë të qeverisjes vendore për të mundësuar që fëmijët romë të përjashtohen nga pagesa e depozitës së garancisë në Tiranë dhe nga pagesat e boreve të prindërve romë në të gjithë vendin...”*

Këtë frymë ka përcjellë edhe Komisionerja për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës, znj. Dunja Mijatović, në raportin e publikuar më datë 13.09.2018, ku në pikën 42 të tij, citon se: *“Pavarësisht nga masat pozitive të marra nga autoritetet shqiptare, mungesa e përfshirja e fëmijëve romë në arsimin e zakonshëm mbetet një çështje shqetësuese. Komisioneri¹² është veçanërisht i shqetësuar për nivelin e raportuar të ulët të regjistrimit të romëve fëmijët në arsimin parashkollor, për shkak të varfërisë, mungesës së regjistrimit, diskriminimit ose mungesës e ndërjegjësimit të prindërve romë për përfitimet e arsimit parashkollor.”*

Gjithashtu, në paragrafin I dhe II, të faqes 2, të Raportit të sipërcituar, znj. Mijatović shprehet se: *“...Komisioneri është i shqetësuar për mungesën e përfshirjes së disa fëmijëve shqiptarë, në veçanti fëmijëve romë dhe fëmijëve me fëmijë aftësi të kufizuara, në arsimin e zakonshëm. Komisioneri u bën thirrje autoriteteve që të mbështesin përpjekjet që synojnë përfshirjen e fëmijëve romë në arsimin e zakonshëm, duke punuar ngushtë me komunitetin e prindërve romë dhe duke rritur përpjekjet për të trajtuar mungesën e përfshirjes së romëve në arsimin parashkollor...”*

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, është evidentuar se: *“Fëmijët romë dhe egjiptianë kanë përqindje të ulëta të regjistrimit në shkollë, alfabetizmit dhe përfundimit të shkollës krahasuar me mesataren kombëtare. Rreth 40,3% e romëve dhe 12,7% e egjiptianëve janë analfabetë, ndërsa mesatarja kombëtare është vetëm 1,6%.¹³”*

Referuar në dhënat e cituara në Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve (2021–2025), rezulton se: *“...aktualisht 14379 djem dhe vajza romë dhe egjiptianë u regjistruan dhe morën pjesë në arsimin parashkollor dhe arsimin e detyrueshëm gjatë vitit 2019. Të dhënat tregojnë se 6767 ishin femra dhe 7612 ishin meshkuj; 4469 ishin romë dhe 9910 ishin egjiptianë; 11196 banonin në zona urbane dhe 3183 banonin në ato rurale. Objektivi i vitit 2019 ishte 4993 fëmijë dhe performanca ndaj objektivit është 287 për*

¹² I referohet znj. Mijatović

¹³ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, fq. 20, paragrafi i fundit.

qind.¹⁴ Ky është një rezultat pozitiv, ndonëse hendeku mbetet i gjerë mes popullsisë rome dhe egjiptiane dhe jorome. Komisioni Evropian shquan si problematike pabarazitë në arsim midis romëve dhe joromëve, të cilat shfaqen që në fillim të jetës me një regjistrim të ulët në arsimin parashkollor (moshat 3–5 vjeç) në Ballkanin Perëndimor.”

Në këto kushte dhe referuar informacionit të sipërcituar, konstatohet se integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian, është një ndër qëllimet strategjike dhe objektivat e Republikës së Shqipërisë.

V. Konkluzione

Në rastin e Bashkisë Tiranë, ishin parashikuar si kategori të veçanta: Fëmijët me statusin e jetimit; Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit; Fëmijë me aftësi të kufizuara; Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuara; Fëmijë të familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës, ndërsa fëmijët e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian nuk janë përcaktuar si kategori më vete.

Lidhur me praktikën e ndjekur nga ana e Bashkisë Tiranë, Komisioneri konstatoi diskriminimin e ankuesve, duke kërkuar në vijim, marrjen e masave të menjëhershme për hartimin dhe përfshirjen e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe egjiptian, si kategori që përfiton rregjistrimin në kopshte pa pagesë.

Në përgjigje të vendimmarrjes së Komisionerit, në pikën 8 të nenin 66, të Vendimit Nr. 158, datë 26.12.2019 “Për Miratimin e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës”, Këshilli Bashkiak Tiranë miratoi si kategori përfituese edhe fëmijët që vijnë nga familje të pakicave rome dhe egjiptiane, duke parashikuar se: “Përfitojnë shërbim pa pagesë familjet në nevojë me përbërje:...8. Fëmijë të familjeve të pakicës rome dhe egjiptiane, sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga organizatat që mbrojnë të drejtat e tyre ose vetë deklarimit ku përcaktohet se familja është pjesë e këtyre pakicave”.

Në këtë kuadër, Komisioneri vlerësoi pozitivisht hapat e ndërmarrë nga ana e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Tiranë dhe çmon se këto veprime të ndërmarra për të stimuluar arsimimin dhe edukimin e fëmijëve që vijnë nga familje të pakicave rome dhe egjiptiane, nëpërmjet përjashtimit nga tarifat e shërbimit të rregjistrimit në kopshte dhe çerdhe, janë një model që duhet ndjekur edhe nga ana e njësisë të tjera të vetëqeverisjes vendore.

Ndërsa nga hetimi i zhvilluar mbi bashkitë e tjera dhe analizimi i informacionit, u evidentua se:

- vetëm 15 % e njësive të vetëqeverisjes kanë hartuar politika specifike, sa i përket regjistrimit pa pagesë të fëmijëve në çerdhe dhe kopshte;
- vetëm 5 % ofrojnë regjistrimin me pagesë të fëmijëve, por që nuk kanë hartuar politika specifike për këtë;

¹⁴ Report on the Implementation of Roma Integration Public Policy in Albania For 2019: www.romalb.org

- vetëm 4 % e njësive të vetëqeverisjes ofrojnë regjistrimin në kopshte dhe ushqimin gjatë drekës, pa pagesë për të gjithë fëmijët;
- 18 % prej tyre nuk kanë asnjë fëmijë të komuniteteve rome dhe egjiptiane të regjistruar në çerdhe dhe kopshte;

Pra, nga analizimi i informacionit të sipërcituar edhe pse nga njësitë e vetëqeverisjes vendore janë evidentuar problematika që lidhen me arsimimin e fëmijëve që vijnë nga komuniteti rom dhe egjiptian, rezulton që nuk janë ndërmarrë masa për përmirësimin e kësaj situatë. Në këtë kuptim, mosmarrja në konsideratë e situatës së arsimimit të fëmijëve që vijnë nga shtresa në nevojë, i vë në vështirësi më të madhe për të aksesuar sistemin arsimor parashkollor.

Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 11, Veprime pozitive, parashikon: *“Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.”*

Si dhe në nenin¹⁵ 6, pika 1 të tij, parashikon se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.”*

GJEDNJ-ja ka theksuar se *“e drejta për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara në KEDNJ po ashtu është shkelur kur shtetet ... nuk i trajtojnë ndryshe personat situata e të cilave janë dukshëm të ndryshme.”*¹⁶ Në mënyrë të ngjashme, direktivat e BE-së për mos-diskriminim parashikojnë shprehimisht mundësinë e veprimit pozitiv, ku thuhet: *“Me synimin për të siguruar barazi të plotë në praktikë, parimi i trajtimit të barabartë nuk do të pengojë asnjë Shtet Anëtar të mbajë ose të miratojë masa specifike për të parandaluar ose të kompensojë disavantazhet e lidhura me (një shkak të mbrojtur”*¹⁷).

Lejueshmëria e marrjes së masave pozitive në favor të grupeve të pafavorizuara përforcohet më tej nga udhëzimet e lëshuara nga disa prej organeve monitoruese përgjegjëse për interpretimin e traktateve të të drejtave të njeriut të OKB-së. Këto organe kanë theksuar që masat e tilla duhet të jenë të përkohshme në natyrë, dhe jo të shtrihen në kohë apo hapësirë përtej asaj që është e nevojshme për të adresuar pabarazinë në fjalë.¹⁸ Sipas Komitetit të OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Racor, në mënyrë që të jenë të lejueshme këto masa duhet të kenë si qëllim vetëm

¹⁵ Neni 6, Trajtimi i ndryshëm i përligjur

¹⁶ ECtHR, *Thlimmenos v. Greece* [GC] (No. 34369/97), 6 April 2000, para. 44. Similarly, ECtHR, *Pretty v. UK* (No. 2346/02), 29 April 2002, para. 88.

¹⁷ Racial Equality Directive, Article 5; Employment Equality Directive, Article 7; Gender Goods and Services Directive, Article 6; and also with a slightly different formulation: Gender Equality Directive (Recast), Article 3.

¹⁸ Handbook on European non-discrimination law fq.38

eliminimin e pabarazive ekzistuese dhe parandalimin e disbalancave të ardhshme.¹⁹ Komisioni i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave thekson se *'masa speciale të përkohshme'* mund të përfshijnë *"trajtim preferencial; rekrutimin, punësimin dhe promovimin; qëllimet numerike të lidhura me kornizat kohore; dhe sistemet e kuotave "*.²⁰

Gjykatat kanë tentuar të trajtojnë diskriminimin në këtë kontekst jo si një formë e veçantë e diskriminimit në vetvete, por si një përjashtim nga ndalimi i diskriminimit. Me fjalë të tjera, gjykatat pranojnë se ka ndodhur trajtimi i ndryshëm, por që mund të justifikohet në interes të korigjimit të një disavantazh të mëparshëm, siç është nën-përfaqësimi në vendin e punës të grupeve të veçanta.²¹

Mbështetur në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, rekomandimet e dhëna nga përfaqësues të partnerëve dhe institucioneve ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut, si dhe referuar të dhënave të grumbulluara, në të cilat është konstatuar niveli i ulët i arsimimit dhe se regjistrimi në arsimin parashkollor është dukshëm më i ulët për fëmijët që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, Republika e Shqipërisë ka hartuar një sërë politikash në funksion të integritetit të komunitetit rom dhe egjiptian, ndër të cilat është edhe arsimi falas për anëtarët e këtyre komuniteteve, për t'i krijuar shanse të barabarta në shoqërinë shqiptare. Regjistrimi i fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në kopësht, krijon baza për zhvillimin e hershëm të këtyre fëmijëve, duke i krijuar akses në sistemin arsimor, si bazë e rëndësishme për integrimin e këtij komuniteti në shoqëri.

Në çështjen *Ponomaryovi v. Bullgarisë* (Nr. 5335/05), 21 qershor 2011, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka cituar ndër të tjera se: *"...arsimimi është një e drejtë që gëzon mbrojtjen e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Gjithashtu arsimi është një lloj tejet i veçantë i shërbimeve publike, që jo vetëm u sjell përfitime atyre që e përdornin atë, por që ka, po ashtu, edhe një funksion më të gjerë shoqëror dhe ishte i pazëvendësueshëm për të çuar më tej të drejtat e njeriut.*

Në çështjen *Thlimmenos kundër Greqisë*²², Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: *"...kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme..."*.

Referuar Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm²³ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sjellim në

¹⁹ UN Committee on the Elimination of Racial Discrimination, 'General Recommendation No. 32: The Meaning and Scope of Special Measures in the International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination' UN Doc. CERD/C/GC/32, 24 September 2009, paras. 21-26.

²⁰ UN Committee on the Elimination of Discrimination Against Women, 'General Recommendation No. 25: Article 4, para. 1 of the Convention (temporary special measures)' UN Doc. A/59/38 (supp), 18 March 2004, para. 22.

²¹ Handbook on European non-discrimination law fq.38

²² *Thlimmenos kundër Greqisë*, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

²³ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

vëmendjen tuaj se e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

Komunitet rome dhe egjiptiane përballen me problematika më të gjëra se gjendja e rënduar ekonomike e tyre të cilat bëhen pengesë për integrimin e tyre në shoqëri. Vetë angazhimet e shtetit Shqiptar për këto problematika janë tregues i qartë i ekzistencës së tyre.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se praktika e ndjekur nga institucionet e qeverisjes vendore, duke mos përfshirë si kategori të veçantë regjistrimin në kopësht të fëmijëve të komunitetin rom dhe egjiptian, i ka trajtuar të gjitha familjet njëloj pa marrë parasysh kushtet e ndryshme sociale që mund të kishin, përbën diskriminim substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) për shkak të etnisë²⁴, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, pasi kemi të bëjmë me trajtimin e çështjes së arsimit të fëmijëve të familjeve të komunitetit rom dhe respektimit të të drejtave të tyre, si një element i theksuar qartë edhe në pesë prioritetet, që vendi ynë duhet të përmbushë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, garantohej për çdo veprim ose mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë. Edhe pse legjislacioni dhe politikat mund të mos jenë diskriminuese, dështimi për të marrë masat për të adresuar diskriminimin *de facto* i cili mund të vijë edhe nga moszbatimi i duhur i tyre, mund të përbëjë shkelje dhe cënim të të drejtës për të mos u diskriminuar.

Trajtimi ndryshe bazuar në një nga shkaqet e ndaluara të diskriminimit, do të përbëjë diskriminim në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm. Për këtë qëllim pjesë e vlerësimit nëse ndodhemi para një situatë diskriminuese, do të jetë nëse qëllimi dhe efektet e veprimeve ose mosveprimeve janë të ligjshme, në përputhje me natyrën e të drejtës dhe vetëm me qëllimin për të promovuar mirëqenien e përgjithshme në një shoqëri demokratike. Për më tepër, duhet të ketë një marrëdhënie të qartë dhe të arsyeshme të proporcionalitetit midis qëllimit të kërkuar për t'u realizuar dhe veprimeve ose mosveprimeve dhe efekteve të tyre. Dështimi për të eliminuar diferencat në trajtim duke u bazuar në mungesën e burimeve financiare, nuk përbën një justifikim të arsyeshëm, vetëm nëse autoritetet përgjegjëse kanë bërë të gjitha përpjekjet për të përdorur burimet e disponueshme, në një përpjekje për të adresuar dhe eliminuar diskriminimin, si një çështje me përparësi²⁵.

²⁴ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, që justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

²⁵ Shiko Komentin e Përgjithshëm nr. 20 “*Mbi Mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*”, të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

Në bazë të ligjit “Për Arsimin Parauniversitar”, bashkitë kanë detyrime në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike në juridiksionin e tyre.

Gjithashtu, sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve²⁶ (2021–2025), për mbështetjen e familjeve rome dhe egjiptiane, fëmijët e të cilëve frekuentojnë arsimin parashkollor dhe atë bazë, ndër të tjera parashikohet, miratimi i VKB-ve për reduktim/përrjashtimin nga detyrimi financiar për çerdhe dhe kopshte për fëmijët nga familjet rome dhe egjiptiane.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim eliminimin e situatës diskriminuese edhe për fëmijët e komuniteteve rome dhe egjiptiane që banojnë në territorin e njësive të tjera vendore të Republikës së Shqipërisë, si dhe bazuar në nenin 32, pika 1, germa “f”, të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

REKOMANDON:

1. Marrjen e masave nga ana e organeve të vetëqeverisjes vendore, për hartimin dhe përfshirjen e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, si kategori që përfitojnë regjistrimin në kopshte dhe çerdhe pa pagesë.
2. Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Etnia)

(Fusha: Arsim)

²⁶ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701, datë 18.11.2021.